

BLERINA KËRÇUKU



Audituese e Dytë në Departamentin e Auditimit të Performancës

Lindur në vitin 1987. Diplomuar në Sociologji. Ndjek Jurisprudencën me kohë të pjesshme, si dhe studimet për Doktoraturë.

Ka 5 vite eksperiencë pune. Lektore pranë Fakultetit të Shkencave Sociale në Universitetin Shtetëror të Tiranës. Prej 1 viti punon si Audituese e Dytë në

Departamentit të Auditimit të Performancës.

Fusha e ekspertizës: Administrimi publik.

TRAJNIMI I AUDITUESVE TË KLSH-SË, VLERË E SHTUAR E DOMOSDOSHME

nga Blerina Kërçuku

Dy dekada u bënë që populli Shqiptar vetëvendosi, që ndryshoi sistemin politiko-ekonomik, për tu rreshtuar në listën e shteteve demokratike, për të ndërtuar shtetin e të së drejtës demokratike e sociale. Sistemi ekonomik i Republikës Shqipërisë bazohet në pronën publike dhe private, të cilat mbrohen me ligj.

Kontrolli i Lartë i Shtetit si një pjesë integrale e administratës publike është një tërësi specialistësh, procesesh dhe kompetencash në të cilën realizohen funksionet publike nëpërmjet sigurimit të kuadrit rregullator dhe mbikëqyrjes së zbatimit të tij, garantimit të standardeve dhe lëvrimit të shërbimeve dhe të mirave publike.

Shteti demokratik i kushton rëndësinë e duhur krijimit të institucioneve, funksionimit të tyre me ligje të miratuara nga kuvendi në frymën e standardeve të pranuar ndërkombëtare dhe krijimin e një administrate profesionale, të përkushtuar dhe të mirë trajnuar vazhdimisht. Këto probleme janë të përcaktuara në Kushtetutën e Republikës të Shqipërisë më së miri.

Pjesa e katërmbëdhjetë (Nenet 162-165), e kushtetutës, autorizon (mandaton) KLSH-në, Z. Bujar Leskaj, si institucionin më të lartë të kontrollit ekonomiko-financiar, që i nënshtrohet vetëm kushtetutës dhe ligjeve i cili ka për detyrë të auditojë pronën dhe fondet publike, kudo që ato ndodhen. Dhe për konstatimet e kontrolleve, i raporton Kuvendit dhe taksapagueseve.

KLSH, funksionon komfort ligjit nr. 8270 date 23.12.1997, ndryshuar me ligjin nr. 8599 datë 01.06.2000, “për Kontrollin e Lartë të Shtetit.”

Në bazë të nenit 20, të këtij ligji, përcaktohet dhe statusi juridik i stafit të punonjësve të KLSH, të cilët nuk duhet të marrin pjesë në veprimtari politike dhe tregtare. Stafi auditues administrohet komfort rregullave që parashikon ligji nr. 8549 datë 11.11.1999 “statusi i nëpunësit civil.” Ky staf duhet të përmbushë detyrat e ngarkuara nga kryetari i KLSH-së, në mënyre profesionale në përputhje me standartet e kontrollit dhe normat etike.

KLSH, nën drejtimin e kryetarit, ka nxjerrë akte rregulluese, të brendshme, për rekrutimin dhe trajnimin e stafit auditues, vlerësimin e performancës zhvillimin profesional etj., të cilat bazohen përveç akteve normative të shërbimit civil në R.SH., edhe udhëzimet e INTOSAIT (Deklaratës Limës viti 1979, Standardet e Kontrollit), EUROSAIT, Gjykata e Llogarisë Bashkimit Evropian (ECA), dhe marrëveshjeve të bashkëpunimit të KLSH-së me disa SAI, si i Turqisë, Polonisë, Sllovenisë, Kroacisë, Kosovës, Austrisë etj..

KLSH, synon që, anëtarët e stafit auditues duhet të kenë kualifikimet dhe integritetin moral të nevojshëm për kryerjen e detyrave të tyre, të kenë shkathtësi dhe të fitojnë përvojë të mirë profesionale, të jenë të komunikueshëm dhe të punojnë mirë në grupe. Vëmendje e veçantë i kushtohet përmirësimit të zhvillimit teorik, praktik dhe profesional përmes programeve të trajnimeve të brendshme, ndërkombëtare dhe universitare.

Trajtim me paga të përshtatshme dhe të diferencuara komfort vjetërsisë në punë dhe shkallës së përgjegjësisë etj..

Një ndër masat e marra nga kryetari për reformën e modernizimit të KLSH, konsiderohet kualifikimi i punonjësve, specializimi sipas departamenteve përkatëse dhe trajnimi nis mbi këtë bazë, duke organizuar seminare me grupe të vogla brenda një departamenti. Pastaj organizohen seminare me përfaqësues të disa departamenteve në rang institucioni.

Burimet njerëzore jo vetëm janë një nga faktorët bazë të ekzistencës së çdo institucioni apo organizate, por për më tepër janë dhe një nga inspiruesit dhe “krijuesit” e faktorëve të tjerë, ndaj dhe kujdesi dhe investimet në burimet njerëzore duhet të përbëjë, dhe në fakt përbën, çështje prioritare të politikave reformuese.



Trajnimi , në përkufizimin më të thjeshtë, është një aktivitet që ndryshon sjelljen e njerëzve në një institucion. Rritja e produktivitetit është arsyeja më e rëndësishme për trajnim. Trajnimi është thelbësore jo vetëm për të rritur produktivitetin, por edhe për të motivuar dhe të frymëzojë të punësuarit duke i krijuar mundësi që të dinë se sa të rëndësishme janë informacionet e marra për realizimin dhe mbarëvajtjen e punës.

Trajnimi do të mësoj pjesëmarrësit/ të punësuarit mbi aspektet psikologjike të udhëheqjes dhe menaxhimit përmes një qasje psikologjike të natyrës njerëzore, kur bëhet fjalë për personalitetin, komunikimin, konfliktin dhe stresin. Trajnimi do të forcojë aftësitë e pjesëmarrësve në kuptimin e funksionit të udhëheqjes përmes njohjes së tipeve të ndryshme të personalitetit që ndikojnë në menaxhim - duke arritur që të kuptojnë

dinamikën e grupeve, të kuptojnë konfliktet dhe t'i menaxhojnë ato, ndërgjegjësim mbi personalitetin si faktor që ndikon në stilin e menaxhmentit, etj..

Dhe në KLSH programet e reja orientuese për të punësuarit e rinj janë mjaft adekuat për të kuptuar rëndësinë e punës në mënyrë të sigurtëdhe efikase.

KLSH synon të nxisë zhvillimin e institucionit, për të patur gjithmonë baza të forta të qëndrueshme dhe profesionale, duke e konsideruar trajnimin si një standard të auditimit. Aktivitetet trajnuese të KLSH kanë synuar të sigurojnë zhvillimin e vazhdueshëm profesional të personelit të tij, duke përfshirë përgatitjen në institucion dhe inkurajimin e pjesëmarrjes së trajnimeve jashtë vendit.

Ashtu siç përcaktohet dhe në Deklaratën e Limës “Udhëzimet për Rregullat e Auditimit” miratuar në Kongresin e IX të INIOSAI-t; Neni 14/3 “Vëmendje e veçantë i kushtohet përmirësimit të zhvillimit teorik, praktik dhe profesional të të gjithë anëtarëve dhe stafit të auditimit, përmes programeve të brendshme, ndërkombëtare dhe universiteteve. Zhvillimi duhet të inkurajohet me të gjitha mjetet e mundshme financiare dhe organizative. Zhvillimi profesional duhet të kalojë kornizën tradicionale të njohurive juridike, ekonomike dhe kontabël dhe të përfshijë teknika të tjera të menaxhimit të biznesit, të tilla si përpunimi elektronik i të dhënave”

Një punonjë sqë merr trajnimin e nevojshëm është më mirë në gjendje për të kryer punën e tij/saj. Ai/ajo bëhet më i vetëdijshëm ndaj praktika vetë sigurisë dhe procedura vetë duhura për detyrat themelore.

Duke qenë pjesë e stafit të ri të punësuar, rëndësia e trajnimeve luan një rol shumë të rëndësishëm për të njohur funksionimin e institucionit, njohjen me të gjitha pjesët organizative të cilat përbejnë bërthamën e KLSH-së.

Ajo çka konsiderohet si shumë evidente vitin e fundit në KLSH-w, është hapësira e nevojshme që i është kushtuar programeve të trajnimit. Çdo i ri i

cili punësohet e ndjen veten i pasigurt dhe përballë një morie informacioni që është e vështirë që ta përpunosh që në ditët e para. Për ta minimizuar sadopak këtë gjendje, trajnimet e organizuara na kanë bërë që informacioni i marrë të jetë shumë i strukturuar dhe të përqendrohet atje ku do të shërbejmë më shumë.

Marrja e një informacioni të përgjithshëm është të njohësh institucionin ku ti punon, por të profilizohesh më shumë në departamentin në të cilin je punësuar, e cila është gjëja më e rëndësishme e institucionit tonë. Realizimi i tyre ka bërë që çdo i ri i punësuar ta gjej veten shumë shpejtë pjesë e rëndësishme e departamentit të tij.

Në këto faza të para (seminare etj.), nën drejtimin e trajnimeve, zhvillohen tema teoriko-praktike mbi njohjen e dispozitave ligjore e nënligjore, konventave etj., si kushtetuta, ligji KLSH-së, njohuri për INTOSAI, EUROSAI, ECA. Merren njohuri nga parimet e deklaratës së Limës, standartet e kontrollit, auditimin financiar, auditime e performancës, rregullat e prokurimit publik etj..

Pjesëmarrja në kurse trajnimi, vizita studimore, konferenca dhe seminare të organizuara nga institucione homologe apo organizata ndërkombëtare jashtë vendit ashtu dhe brenda vendit, plotëson nevojat e audituesve në vazhdimësi si vlerë e shtuar e domosdoshme.

ⁱ Botuar në gazetën “Ekonomia” datë 12 dhjetor 2013.